

2015 SP
30.4.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E FINANCAVE
Nr. 6619
Datë 30 4 15

V E N D I M

Nr. 351 , datë 29.4.2015

P Ë R

DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës "A", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Talibanët", të regjistrohen individët e renditur në shkronjën "a", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Talibanët.
2. Në listën e shkronjës "B", "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me Talibanët", të regjistrohen individët e renditur në shkronjën "b", të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Talibanët.

3. Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën “Al-Qaida”, të regjistrohen individët e renditur në shkronjën “c”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën “Al-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

**MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME**

DITMIR BUSHATI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

SELIM BELORTAJA

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-
së”)

**A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
TALIBANËT**

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me
Talibanët”;

1. ABDUL BASIR; NOORZAI.

**B. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË
ME TALIBANËT**

b) Lista e shtuar në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë
me Talibanët”;

1. HAJI BASIR AND ZARJMIL COMPANY HAWALA.

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATËN AL-QAIDA**

c) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me
organizatën Al-Qaida”;

1. ALI; BEN TAHER; BEN FALEH; OUNI HARZI,
2. TARAK; BEN TAHER; BEN FALEH; OUNI HARZI.

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personat emrat e të cilave janë radhitur më
sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të
Parave.